



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2018

PËR

MIRATIMIN E KUSHTEVE TË POSAÇME TË LICENCIMIT, DOKUMENTET SHOQËRUESE, SI DHE PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN DHE REVOKIMIN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË ARKEOLOGJIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 136, 137, pikës 5 të nenit 157, të ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Çdo individ apo person juridik, që kërkon të ushtrojë veprimtari në fushën e arkeologjisë, duhet të pajiset me licencën profesionale përkatëse bazuar në kushtet e parashikuara në këtë vendim.
2. Miratim e kushtëve të posaçme të licensimit, dokumentat shoqëruesë, si dhe procedurat e shqyrtimit dhe revokimit të licencës për veprimtarinë arkeologjike, sipas rregullores bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

**RREGULLORE
PËR
PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE TË POSAÇME TË LICENCIMIT, DOKUMENTET
SHOQËRUESE, SI DHE PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN DHE REVOKIMIN E
LICENCËS PËR VEPRIMTARINË ARKEOLOGJIKE**

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Objekti i rregullores dhe fusha e veprimit

1. Kjo rregullore përcakton dhe shtrin fushën e veprimit në:
 - a) Llojet e licencave dhe kushtet për licencim për veprimtarinë arkeologjike;
 - b) Dokumentacioni për pajisjen me licencë profesionale;
 - c) Procedura për shqyrtimin për dhënien dhe revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike;
 - d) Procedura për shqyrtimin për dhënien dhe revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike;
 - e) Format i licencës për veprimtarinë arkeologjike, regjistrimi dhe arkivimi i tyre;

**KREU II
LLOJET E LICENCAVE DHE KUSHTET PËR LICENCIM**

Neni 2

Llojet dhe kategoritë e licencave për veprimtarinë arkeologjike

1. Licenca është akti administrativ, që i njeh titullarit të saj të drejtën të fillojë e të ushtrojë profesionalisht veprimtari në fushën arkeologjisë.
2. Lloje të licencave për veprimtarinë arkeologjike janë:
 - a) Licenca për veprimtarinë arkeologjike për individët;
 - b) Licenca për veprimtarinë arkeologjike për persona juridik.
3. Licencat për veprimtarinë arkeologjike për individët ose juridik, jepen për këto kategori:
 - a) **A.** Për veprimtarinë arkeologjike.
 - i. **A1.** Vëzhgim arkeologjik (Survey).
 - ii. **A2.** Sondazhe arkeologjike.
 - iii. **A3.** Gërmim arkeologjik.
 - b) **B.** Për veprimtarinë arkeologjike nënujore.
 - i. **B1.** Vëzhgim arkeologjik (Survey) nënujor.
 - ii. **B2.** Sondazh arkeologjik nënujor.
 - iii. **B3.** Gërmim arkeologjik nënujor.

Neni 3

Kushtet e posaçme për licence profesionale individuale

Kushtet e posaçme për licencim për veprimtari arkeologjike profesionale individuale janë:

1. Për licence **A1- Vëzhgim arkeologjik (Survey)**.
 - a) Të zotërojë diplomë të nivelit master profesional apo shkencor, apo diplomë të integruar të nivelit të dytë (përfshirë rastet kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore), në profilin arkeologjik, trashëgimi kulturore të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuara sipas dispozitave në fuqi, apo të ketë njehsuar pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin, diplomën ekuivalente, të lëshuar nga institucionet e huaja;
 - b) Të ketë eksperiencë si pjesëmarrës në të paktën 5 (pesë) projekte për veprimtari arkeologjike, brenda dhe/ose jashtë vendit, e vërtetuar nga institucioni apo nga drejtuesi i projektit dhe me dokumentacion të projektit të miratuar.

2. Për licencë **A2- Sondazh Arkeologjik**.
 - a) Të zotërojë diplomë të nivelit master profesional apo shkencor, apo diplomë të integruar të nivelit të dytë (përfshirë rastet kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore), në profilin arkeologjik, trashëgimi kulturore, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuara sipas dispozitave në fuqi, apo të ketë njehsuar pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin, diplomën ekuivalente, të lëshuar nga institucionet e huaja;
 - b) Të jetë autor dhe/ose bashkautor në të paktën 3 (tre) projekte arkeologjike brenda dhe/ose jashtë vendit e vërtetuar nga institucioni apo nga drejtuesi i projektit dhe me dokumentacion të projektit të miratuar.

3. Për licencë **A3- Gërmim Arkeologjik**.
 - a) Të zotërojë diplomë të nivelit master profesional apo shkencor, apo diplomë të integruar të nivelit të dytë (përfshirë rastet kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore), në profilin arkeologjik trashëgimi kulturore, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuara sipas dispozitave në fuqi, apo të ketë njehsuar pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin, diplomën ekuivalente, të lëshuar nga institucionet e huaja;
 - b) Të jetë autor në të paktën 5 projekte brenda dhe/ose jashtë vendit, ku në 3 prej tyre të ketë qënë drejtues projekti vërtetuar nga institucioni apo nga drejtuesi i projektit dhe me dokumentacion të projektit të miratuar.

4. Për licencë **B1- Vëzhgim arkeologjik (Survey) nënujor**.
 - a) Të zotërojë diplomë të nivelit master profesional apo shkencor, apo diplomë të integruar të nivelit të dytë (përfshirë rastet kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore), në profilin arkeologjik trashëgimi kulturore, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuara sipas dispozitave në fuqi, apo të ketë njehsuar pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin, diplomën ekuivalente, të lëshuar nga institucionet e huaja;
 - b) Të zotërojë gradën e tretë të zhytësit, ose superiore, të mbrojtur me një nga shkollat didaktike e njohura si SSI, CMAS, PADI ose të ngjashme.

- c) Të zotërojë dokument për sigurimin për jetën në standardet e Agjencisë Ndërkombëtare për Sigurimin e Zhytëseve DAN EUROPE.
- d) Të ketë eksperiencë si pjesëmarrës në të paktën 3 (tre) projekte për veprimtari arkeologjike nënujore, brenda dhe/ose jashtë vendit, e vërtetuar nga institucioni apo nga drejtuesi i projektit dhe me dokumentacion të projektit të miratuar.

5. Për licencë **B2- Sondazh arkeologjik nënujor.**

- a) Të zotërojë diplomë të nivelit master profesional apo shkencor, apo diplomë të integruar të nivelit të dytë (përfshirë rastet kur parashikohet ndryshe në këtë rregullorë), në profilin arkeologjik, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuara sipas dispozitave në fuqi, apo të ketë njehsuar pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin, diplomën ekuivalente, të lëshuar nga institucionet e huaja;
- a) Të zotërojë gradën e tretë të zhytësit, ose superiore, të mbrojtur me një nga shkollat didaktike e njohura si SSI, CMAS, PADI ose të ngjashme.
- b) Të zotërojë dokument për sigurimin për jetën në standardet e Agjencisë Ndërkombëtare për Sigurimin e Zhytëseve DAN EUROPE.
- c) Të jetë autor dhe/ose bashkautor në të paktën 5 (pesë) projekte arkeologjike nënujore brenda dhe/ose jashtë vendit e vërtetuar nga institucioni apo nga drejtuesi i projektit dhe me dokumentacion të projektit të miratuar.

6. Për licencë **B3- Gërmim Arkeologjik nënujor.**

- a) Të zotërojë diplomë të nivelit master profesional apo shkencor, apo diplomë të integruar të nivelit të dytë (përfshirë rastet kur parashikohet ndryshe në këtë rregullorë), në profilin arkeologjik, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuara sipas dispozitave në fuqi, apo të ketë njehsuar pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin, diplomën ekuivalente, të lëshuar nga institucionet e huaja;
- b) Të zotërojë gradën e tretë të zhytësit, ose superiore, të mbrojtur me një nga shkollat didaktike e njohura si SSI, CMAS, PADI ose të ngjashme.
- c) Të zotërojë dokument për sigurimin për jetën në standardet e Agjencisë Ndërkombëtare për Sigurimin e Zhytëseve DAN EUROPE.
- d) Të jetë autor në të paktën 5 projekte brenda dhe/ose jashtë vendit, ku në 3 prej tyre të ketë qenë drejtues projekti vërtetuar nga dokumenti i konfirmuar (origjinal ose fotokopje e noterizuar) nga institucioni apo nga drejtuesi i projektit dhe me dokumentacion të projektit të miratuar.

Neni 4

Kushtet e posaçme për licencë profesionale për personat juridik

- 1. Kushtet e posaçme për licence për veprimtarinë arkeologjike për persona juridikë janë:
 - a) Të jenë regjistruar si person juridik, sipas dispozitave ligjore në fuqi, për të ushtruar veprimtari në fushën e arkeologjisë;
 - b) Të ketë të punësuar një ose më shume arkeolog-konservues të diplomuar me diplomë të nivelit master profesional apo shkencor në arkeologji të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuara sipas dispozitave në fuqi, apo të ketë njehsuar pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin, diplomën ekuivalente, të lëshuar nga institucionet e huaja;

- c) Personi juridik licencohet për kategorinë/kategoritë e licencës për veprimtarinë arkeologjike që disponon individi me të cilin personit juridik ka lidhur kontratën e punësimit.
- d) Personi juridik duhet të ketë të punësuar
- e) Të jenë regjistruar si subjekt juridik sipas dispozitave ligjore për të ushtruar veprimtari në fushën e arkeologjisë.
- f) Personi juridik duhet të ketë statusin “aktiv” të ushtrimit të veprimtarisë.
- g) Individi që disponon licencën profesionale për veprimtarinë arkeologjike e ushtron veprimtarinë e tij vetëm pranë një personi juridik.
- h) Në rast se individi që disponon licencën për veprimtarinë arkeologjike i punësuar pranë personit juridik shkëput marrëdhëniet e punës me personin juridik njofton pranë sekretarisë teknike të IKTK-së, e cila dërgon për shqyrtim në KKTKM.

Neni 5

Kufizime për tërheqjen dhe përdorimin e licencës

1. Licenca nuk lejohet të tjetërsohet apo trashëgohet, nga një individ apo person juridik tek tjetri.
2. Kur një individ apo person juridik humbet licencën profesionale, njofton menjëherë, zyrtarisht, Sekretariatit Teknik.
3. Licencat individuale tërhiqen nga vetë personi i licencuar, ose nga persona të autorizuar me akte noteriale për të kryer një veprim të tillë (kopja e autorizimit noterial depozitohet në dosjen që arkivohet).
4. Licencat e shoqërive tërhiqen nga përfaqësuesi ligjor, ose persona të autorizuar me akte noteriale për të kryer një veprim të tillë (kopja e autorizimit noterial depozitohet në dosjen që arkivohet), ose nga drejtuesit teknikë të shoqërisë.
5. Shoqëritë që janë pajisur me licencë të re, si rezultat i ndryshimit të drejtuesve teknikë, përfaqësuesve ligjorë, apo ndryshim të emrit apo selisë, përpara se të tërheqin licencën, duhet të dorëzojnë origjinalin e licencës paraardhëse. Origjinali shënjohe nga Sekretariati Teknik me prerje në anë dhe arkivohet në dosjen e subjektit, pranë arkivës së Sekretariatit.

Neni 6

Kufizime në dhënien e licencës

1. Profesionistët që punojnë në Ministrinë përgjegjëse për kulturën dhe institucionet e varësisë së saj kanë të drejtë të bëjnë kërkesë pranë sportelit unik/sekretarisë teknike pranë IKTK-së për licencë. Kjo kategori pajiset me vërtetim për miratimin e licencës. Të drejtën e marrjes së kartonit dhe fillimin e efekteve, për ushtrimin e veprimtarisë e ka vetëm në momentin e shkëputjes së tyre nga puna.
2. Anëtarët e KKTKM-së kanë të drejtë të ushtrojnë licencën në veprimtaritë arkeologjike. Në vendimarrje për projekte për të cilët ata janë autorë nuk kanë të drejtë vote, duke u larguar nga mbledhja për periudhën e shqyrtimit dhe miratimit të projektit. Në vendimmarrjen për miratimin për dhënien e licencës nuk kanë të drejtë vote.
3. Licencat për veprimtarinë arkeologjike në territorin e Republikës së Shqipërisë njihen vetëm ato të lëshuara nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale.

Neni 7

Afatet e vlefshmërisë së Licencës

1. Afatet e vlefshmërisë së licencave për veprimtarinë arkeologjike nga data e lëshimit të tyre janë:
 - a) licencat për veprimtarinë arkeologjike për individët jepen pa afat.
 - b) licencat për veprimtarinë arkeologjike për personat juridik, jepen sa afati i vlefshmërisë së kontratës që ka ky person juridik ka lidhur kontratën e punësimit me individin i cili disponon licencë për veprimtarinë arkeologjike por jo më shumë se 5 vjet. Kontrata e punësimit ndërmjet personit juridik dhe individit nuk mund të jetë më pak se 1 vit.

KREU III

KUSHTET DOKUMENTARE PËR PAJISJEN ME LICENCË PROFESIONALE DHE REGJISTRIMI PROFESIONAL

Neni 8

Dokumente shoqëruese për marrjen e licencës profesionale individuale

1. Aplikimi për pajisje me licencë individuale për herë të parë, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet e posaçme të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:
 - a) Kërkesën e individit, ku të përcaktohen të paktën gjeneralitetet, adresa e plotë e individit dhe kategoritë, me të cilat individi kërkon të licencohet;
 - b) Kartën e identitetit;
 - c) Diplomën që zotëron;
 - d) CV e individit, ku pasqyrohet veprimtaria e tij e kryer nga marrja e diplomës ;
 - a) Dokumentacion teknik justifikues, për çfarë është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma; projekte (ose pjesë të tyre) ku personi ka qenë bashkautor; certifikata kursi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën ku kërkon të licencohet. Të gjitha vërtetimet dhe projektet, duhet të kenë patjetër të përhurë, adresën postare dhe elektronike të subjektit që ka lëshuar vërtetimin apo që ka hartuar projektin, në të kundërt dokumenti nuk do të konsiderohet si dokument justifikues për eksperiencën. Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të përkthehen pranë një përkthyesi zyrtar.
 - b) Vetëdeklarimin e individit, mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të licencohet dhe mbi angazhimin të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e tij kushtet teknike dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e arkeologjisë;
 - c) dy kopje fotografish 3x4cm (fotografi të pesë muajve të fundit).
 - d) Kopje diplomës e noterizuar.
 - e) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për pajisje me licencë profesionale individuale për veprimtarinë arkeologjike.
2. Në rast të rinovimit të licencës profesionale individuale, nga individi paraqitet dokumentacioni i parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 9

Dokumente shoqërues për pajisje me shtesa në kategoritë e licencës individuale

1. Aplikimi për pajisje me shtesa në licencën individuale ekzistuese, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet e posaçme të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

- a) Kërkesën e individit, ku të përcaktohen kategoritë të cilat individi kërkon ti shtohen në licencë nga aplikimi i mëparshëm;
- b) Kartën e identitetit;
- c) CV e individit, ku pasqyrohet veprimtaria e tij e kryer nga aplikimi paraardhës ;
- d) Dokumentacion teknik justifikues, për çfarë është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma; projekte (ose pjesë të tyre) ku personi ka qenë bashkautor; certifikata kursi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën ku kërkon të licencohet. Të gjitha vërtetimet dhe projektet, duhet të kenë patjetër të përsirë, adresën postare dhe elektronike të subjektit që ka lëshuar vërtetimin apo që ka hartuar projektin, në të kundërt dokumenti nuk do të konsiderohet si dokument justifikues për eksperiencën. Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të përkthehen pranë një përkthyesi zyrtar.
- e) Vetëdeklarimin e individit, mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të licencohet dhe mbi angazhimin të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e tij kushtet teknike dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e arkeologjisë;
- f) dy kopje fotografish 3x4cm (fotografi të pesë muajve të fundit).
- g) Kopje diplomës e noterizuar.
- h) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për pajisje me licencë profesionale individuale për veprimtarinë arkeologjike.

Neni 10

Për dublikatë të licencës individuale

1. Aplikimi për pajisjen me dublikatë të licencës individuale, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet e posaçme të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:
 - a) Kërkesën e individit, ku të përcaktohen të dhënat e licencës që kërkon të dublohet, dhe arsyt e kërkesës;
 - b) Vetëdeklarimin e individit, mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të licencohet, si dhe gjendjen në lidhje me penalizime nga strukturat shtetërore të inspektimit në këtë fushë;
 - c) Dy fotografi për dokument, të individit që kërkon të licencohet (fotografi të 5 muajve të fundit);
 - d) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për pajisje me licencë profesionale.

Neni 11

Për pajisje me licencë të personit juridik

1. Aplikimi për pajisje me licencë të personit juridik, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet e posaçme të specifikuara në këtë rregullore, për secilën kategori, shoqërohet me:
 - a) Kërkesë të përfaqësuesit ligjor të personit juridik, ku të përcaktohet, të paktën, emërtimi, rezidenca, adresa e plotë, përfaqësuesit ligjorë e drejtuesit teknikë të shoqërisë;
 - b) Ekstraktin historik apo ekstraktin për të dhënat e subjektit të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (i lëshuar jo më parë se 1 muaj nga aplikimi), me të cilin dëshmohet, ndër të tjera, veprimtaria dhe statusi aktiv i personit juridik/ose vendimin e

- gjykatës, për regjistrim si subjekt juridik.
- c) Vetëdeklarim i përfaqësuesit/përfaqësuesve ligjorë, mbi gjendjen e tij/tyre në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë ku kërkon të licencohet dhe mbi angazhimin të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e tij kushtet teknike dhe të gjitha legjislacionin në fuqi në fushën e arkeologjisë
 - ç) Kontratë midis përfaqësuesit ligjor dhe individit i cili disponon licencën për veprimtarinë arkeologjike, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit);
 - d) Vetëdeklarim i individit në silësinë e drejtuesit/drejtuesve teknikë:
 - i) mbi gjendjen e tij, në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë, për të cilën është kontraktuar;
 - ii) për gjendjen, në lidhje me punësimin si drejtues teknik në persona juridik të tjerë, që ushtrojnë veprimtari në fushën e arkeologjisë;
 - iii) për gjendjen e të qenit apo jo në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore, vendore, të pavarura, apo persona juridikë të tjerë publik;
 - e) Vërtetim nga organet tatimore për shlyerjen nga shoqëria, të të gjitha detyrimeve tatimore;
 - f) Kopje të licencës për veprimtarinë arkeologjike të individit, të punësuar pranë tij.
 - g) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për pajisje me licencë për veprimtari arkeologjike për persona juridikë.

Neni 12

Për pajisje me shtesa në kategoritë e licencës së personit juridik

1. Aplikimi për pajisje me shtesa të kategorive në licencën ekzistuese të personit juridik (pa kërkuar ndryshime apo shtesa në drejtuesit teknik të shoqërisë), pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet e posaçme të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:
 - a) Kërkesë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë, ku të përcaktohet të paktën, kategoritë që kërkohen të shtohen;
 - b) Kontratat midis përfaqësuesit ligjor dhe individit/drejtuesit teknik i cili disponon licencën për veprimtarinë arkeologjike, të hartuara përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit), për rastet kur kontratave të depozituara më parë u ka kaluar afati i vlefshmërisë;
 - c) Vetëdeklarim i përfaqësuesit/përfaqësuesve ligjorë, mbi gjendjen e tij/tyre në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë ku kërkon të licencohet dhe mbi angazhimin të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e tij kushtet teknike dhe të gjitha legjislacionin në fuqi në fushën e arkeologjisë;
 - d) Vetëdeklarim i individit në silësinë e drejtuesit/drejtuesve teknikë:
 - i) mbi gjendjen e tij, në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë, për të cilën është kontraktuar;
 - ii) për gjendjen, në lidhje me punësimin si drejtues teknik në persona juridik të tjerë, që ushtrojnë veprimtari në fushën e arkeologjisë;
 - iii) për gjendjen e të qenit apo jo në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore, vendore, të pavarura, apo persona juridikë të tjerë publik;
 - e) Vërtetim nga organet tatimore për shlyerjen nga shoqëria, të të gjitha detyrimeve tatimore;
 - f) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për pajisje me licencë për veprimtari arkeologjike për persona juridikë.

Neni 13

Për zgjatjen e afatit të licencës së personit juridik apo dublikatë

1. Aplikimi për zgjatjen e afatit të licencës ekzistuese të shoqërisë (pa kërkuar ndryshime apo shtesa në drejtuesit teknikë të shoqërisë, apo rinovim të kategorive, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet e posaçme të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:
 - a) Kërkesë e përfaqësuesit ligjor të personit juridik, që kërkon zgjatje të afatit të licencës apo dublikatë. Për rastet kur kërkohet dublikatë, të përcaktohen të dhënat e licencës që kërkon të dublohet dhe arsyet e kërkesës për dublikatë;
 - b) Kontratat midis përfaqësuesit ligjor dhe individit/drejtuesit teknik i cili disponon licencën për veprimtarinë arkeologjike, të hartuara përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit), për rastet kur kontratave të depozituara më parë u ka kaluar afati i vlefshmërisë;
 - c) Vetëdeklarim i përfaqësuesit/përfaqësuesve ligjorë, mbi gjendjen e tij/tyre në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë ku kërkon të rilicencohet dhe mbi angazhimin të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e tij kushtet teknike dhe të gjitha legjislacionin në fuqi në fushën e arkeologjisë;
 - ç) Vetëdeklarim i individit në silësinë e drejtuesit/drejtuesve teknikë:
 - i) mbi gjendjen e tij, në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë, për të cilën është kontraktuar;
 - ii) për gjendjen, në lidhje me punësimin si drejtues teknik në persona juridik të tjerë, që ushtrojnë veprimtari në fushën e arkeologjisë;
 - iii) për gjendjen e të qenit apo jo në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore, vendore, të pavarura, apo persona juridikë të tjerë publik;
 - d) Vërtetim nga organet tatimore për shlyerjen nga shoqëria, të të gjitha detyrimeve tatimore;
 - dh) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për pajisje me licencë për veprimtari arkeologjike për persona juridikë.

Neni 14

Dokumente shoqëruese për ndryshimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike të personat juridikë

1. Kërkesa për ndryshim të licencës për veprimtarinë arkeologjike për persona juridikë bëhet në rastet kur:
 - a) Personi juridik shton numrin e të punësuarve (individ) të cilët disponojnë licenca për veprimtarinë arkeologjike;
 - b) Personi juridik ndërpret marrëdhënien e punës me të punësuarin (individ) i cili disponon licencën për veprimtarinë arkeologjike.
 - c) Ndryshimi i të dhënave të titullit dhe ose selisë, që nuk kanë të bëjnë me kriteret e përcaktuara në këtë vendim.
2. Kërkesa për ndryshim të licencës për veprimtarinë arkeologjike në rastin e shtimit të të punësuarve sipas germës “a” të pikës 1 të këtij neni, paraqitet nga personi juridik dhe duhet të shoqërohet me:
 - a) Kontratë midis përfaqësuesit ligjor dhe individit i cili disponon licencën për veprimtarinë arkeologjike, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit);
 - b) Vetëdeklarim i individit në silësinë e drejtuesit/drejtuesve teknikë:
 - i) mbi gjendjen e tij, në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë, për të cilën është kontraktuar;
 - ii) për gjendjen, në lidhje me punësimin si drejtues teknik në persona juridik të tjerë, që ushtrojnë veprimtari në fushën e arkeologjisë;

- iii) për gjendjen e të qenit apo jo në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore, vendore, të pavarura, apo persona juridikë të tjerë publik;
 - c) Kopje të licencës për veprimtarinë arkeologjike të individit, të punësuar pranë tij.
 - a) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për pajisje me licencë për veprimtari arkeologjike për persona juridikë.
3. Kërkesa për ndryshim të licencës për veprimtarinë arkeologjike në rastin e largimit të të punësuarve sipas germës “b” të pikës 1 të këtij neni, paraqitet nga personi juridik dhe duhet të shoqërohet me:
- a) Kërkesë me shkrim nga individit që disponojnë licencën për veprimtarinë arkeologjike për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me personin juridik ose vërtetim nga personi juridik për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.
 - b) Kopje të licencës së personit që disponojnë licencën për veprimtarinë arkeologjike të cilët do të largohen tek personi juridik.
4. Kërkesa për ndryshim të licencës për veprimtarinë arkeologjike në rastin kur përgjatë kryerjes së veprimtarisë ndodh ndryshimi faktik i të dhënave të përcaktuara në licencë sipas germës “c” të pikës 1 të këtij neni, të cilat nuk kanë të bëjnë me kriteret e licencimit, ky ndryshim i njoftohet, sekretarisë teknike pranë IKTK-së, me kërkesë të drejtuesit ligjor të personit juridik duke depozituar edhe dokumentacionin që vërteton ndryshimin e njërës prej elementëve të përcaktuar në licencë sipas rastit.

Neni 15

Mbyllja e aktivitetit të personit juridik

1. Njoftimi për mbylljen e aktivitetit të personit juridik në lidhje me veprimtarinë arkeologjike, paraqitet pranë Sekretarisë Teknike të IKTK-së dhe shoqërohet me:
 - a) Njoftim me shkrim, nga drejtuesi ligjor, për mbylljen e aktivitetit;
 - b) Dorëzimin e licencës/licencave për veprimtarinë arkeologjike që disponon.

KREU IV

PROCEDURA PËR SHQYRTIMIN PËR DHËNIEN DHE REVOKIMIN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË ARKEOLOGJIKE

Neni 16

Dorëzimi dhe pranimi i kërkesave

1. Kërkesa për licencë për veprimtari arkeologjike dhe dokumentet shoqëruese të saj sipas këtij vendimi, dërgohen në formë shkresore nëpërmjet shërbimit postar pranë Sportelit Unik/Sekretarisë Teknike të IKTK-së. Çdo kërkesë dhe dokumentacioni shoqërues sipas këtij vendimi duhet të jetë në format letër dhe në gjuhën shqipe.
2. Sekretaria teknike e IKTK-së, brenda 10 ditëve pune nga depozitimi i kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues verifikon nëse kjo kërkesë ka të përfshirë të gjithë kriteret formalë të parashikuara në këtë vendim. Në rast se sekretaria teknike konstaton mangësi apo pasaktësi në dokumentacion, njoftohet kërkuesi nëpërmjet postës elektronike për mangësitë apo pasaktësitë e dokumentacionit.
3. Kërkuesit i lihet një afat prej 10 ditësh pune për të plotësuar mangësitë apo pasaktësitë e konstatuara.
4. Në rast se kërkuesi nuk i plotëson mangësitë apo pasaktësitë e konstatuara brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij kreu, sekretaria teknike kthen dosjen te kërkuesi me shënimin “dosje e refuzuar”.

5. Sekretaria teknike e IKTK-së përcjell pranë KKTKM-së për shqyrtim dhe vendimmarrje kartelën shoqëruese të praktikës
6. KKTKM-ja shqyrton dhe merr vendim për dhënien e licencës për veprimtarinë arkeologjike brenda 60 ditëve nga depozitimi i kërkesës në sekretarinë teknike.
7. Sekretaria teknike, në bazë të vendimit të KKTKM-së, zbardh dokumentin e licencës për veprimtarinë arkeologjike në dy kopje origjinale, njëra prej të cilave pas nënshkrimit nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, ndërsa kopja tjetër ruhet në arkivin e IKTK-së.
8. Shpërndarja e licencave të interesuarve bëhet jo më vonë se 30 ditë nga marrja e vendimit të KKTKM-së nëpërmjet shërbimit postar.
9. Licenca e miratuar për veprimtarinë arkeologjike regjistrohet në regjistrin e licencave për veprimtaritë arkeologjike, i cili administrohet nga IKTK-ja si dhe Regjistrat Themeltarë të Licencave Profesionale Personale dhe të Shoqërive.

Neni 17 **Revokimi i licencës**

1. Për çdo konstatim të rasteve të parashikuara në nenin 138 të ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzeve”, IKTK-ja harton një raport vlerësimi të fakteve të depozituara nga institucionet përkatëse sipas rastit dhe ia kalon për shqyrtim KKTKM-së, i cili merr vendim për revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike.
2. KKTKM-ja shqyrton të gjithë raportet e vlerësimit të institucioneve të specializuara.
3. Licenca për veprimtarinë arkeologjike për individët konsiderohet e revokuar kur mbajtësi i saj humbet jetën.

KREU V **FORMATI I LICENCËS PËR VEPRIMTARINË ARKEOLOGJIKE, REGJISTRIMI** **DHE ARKIVIMI I TYRE**

Neni 18 **Formati i licencës**

1. Licencat për veprimtarinë arkeologjike janë dokumente me vlerë që i nënshtrohen prodhimit të posaçëm.
2. Format i tyre miratohet nga KKTKM-ja.
3. Licenca përmban, të paktën, këto të dhëna:
 - a) emrin dhe stemën e Ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;
 - b) serinë, numrin dhe datën e miratimit dhe të hyrjes në fuqi;
 - c) të dhënat për identifikimin e mbajtësit të licencës;
 - d) llojin e licencës dhe kategorinë e veprimtarisë arkeologjike
 - e) afatin e vlefshmërisë;
 - f) nënshkrimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe vulën përkatëse të institucionit;
 - g) Aneksin (faqja e pasme e licencës). Aneksi përmban të gjithë llojet e kategoritë e licencave për veprimtaritë arkeologjike.

Neni 19 **Rregjistrimi i licencës**

1. IKTK përgjigjet për arkivimin, sipas rregullave, të licencave dhe gjithë dokumentacionit duke përfshirë edhe mandatin e arkëtimit për pagesën sipas tarifave përkatëse.
2. IKTK mban dhe ruan sipas rregullave në fuqi:
 - a) Protokoll për evidentimin e kërkesave të individëve dhe personave juridikë për licencë për veprimtari arkeologjike.
 - b) Regjistër themeltar për regjistrimin e licencave për veprimtari arkeologjike për individët dhe personat juridikë.
3. Regjistrat janë dokumente, në përgjegjësi të sekretarisë teknike të IKTK-së, ku regjistrohen të dhënat e licencimit të subjekteve, sa herë ato trajtohen dhe u miratohet licencimi, si dhe pasqyrohen të paktën parametrat:
 - a) emërtimi i subjektit të licencuar;
 - b) numri dhe data e vendimit në të cilin është miratuar licenca e subjektit;
 - c) numri i licencës;
 - d) kategoritë e miratuara;
 - e) afati i vlefshmërisë.
4. Regjistrat janë dokumente publikë të cilat janë në përgjegjësi të Sekretarisë teknike, publikohen në faqen zyrtare të IKTK-së dhe u mundësohet aksesimi në to, çdo individ apo personi juridik.

KREU VI DISPOZITA KALIMTARE

Neni 20

1. Individët e licencuar në arkeologji, të cilëve u është miratuar licenca nga KKA përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të konsiderohen të vlefshme deri në 24 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Gjatë kësaj periudhe ata duhet të drejtohen KKTKM-së për rinovim dhe rikategorizim të licencave, sipas kushteve të parashikuara nga ky vendim.
2. Personat juridik e Licencuara në Arkeologji, të cilave u është miratuar licenca nga KKA përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje do të konsiderohen të vlefshme deri në 24 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Gjatë kësaj periudhe ato duhet të drejtohen KKTKM-së në të njëjtën kohë me drejtuesin teknik për rinovimin dhe rikategorizimin e licencave sipas kushteve të parashikuara në këtë vendim.
3. Të gjitha aplikimet për licencë për veprimtarinë arkeologjike, për të cilat nuk është marrë ende vendimi, do të shqyrtohen sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim.
4. Të gjitha aplikimet për licenca për veprimtarinë arkeologjike dhe aktet formale në lidhje me to bëhen me pagesë, sipas udhëzimit të përbashkët të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministrit përgjegjës për financat.